

Misioni

Të identifikojë familjet më të varfëra në territorin e bashkisë dhe të zbatojë kriteret ligjore përsa i përket dhënies së ndihmës ekonomike.

Të planifikojë dhe të administrojë fondet për trajtimin e personave me aftësi të kufizuar si dhe pagesat për invalidët e punës.

Të identifikojë nevojat e grupeve sociale në rrezik si fëmijët, të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuar, të moshuarit dhe minoritetet për shërbime sociale.

Ndihma Ekonomike referuar ndryshimeve ligjore, tanimë bazohet në një *Sistem Elektronik Aplikimi dhe Vlerësimi* mbi bazën e disa variablave të përcaktuar si indikatorë të nivelit të varferisë dhe ballafaqimit të tyre në mënyrë elektronike me të dhënat e institucioneve të lidhura me këtë proces.

Drejtoria përbëhet nga

1. Sektori I Ndhmës ekonomike dhe Strehimit
 - Përgjegjës sektori
 - Specialist I Nd. Ek dhe Pak
 - Nepunës strehimi
 - Specialist për dhunën në familje dhe barazisë gjinore

2. Sektori I Shërbimeve Sociale
 - Specialist për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve
 - Specialis për shërbimet sociale

KUSH MUND TË MARRË NDIHMË EKONOMIKE ?

Ndihmën ekonomike mund ta marrin :

- Familjet me të ardhura të pamjaftueshme ose me të ardhura të pamjaftueshme
- Prindër me më shumë se tre fëmijë të lindur njëherësh që u përkasin familjeve në nevojë
- Jetimët që nuk janë në institucione
- Viktimat e trafikimit pas daljes nga institucionete përkujdesjes shoqërore deri në castin e punësimit
- Viktimat e dhunës në mardhëniet familjare për periudhën e vlefshmërisë së urdhërit të mbrojtjes

CFARË DOKUMENTASH DUHET TË DORZOJNË BASHKË ME APLIKIMIN?

- Kartën e identitetit për të gjithë anëtarët që kanë kartë
- Dokumenti i pronësisë të tokës
- Vërtetim toke
- Certifikatë trungu '91- '92

PO NËSE BASHKËSHORTËT JANË NË PORCES ZGJIDHJE MARTESE ?

- Bëhet aplikimi duke dorëzuar në aplikim vërtetimin e gjykatës që bashkëshortët janë në process zgjidhje martese

KUR DUHET BËRË APLIKIMI?

- Aplikimi bëhet nga data 1-10 cdo muaj pranë njesise administrative ku banon

KU DUHET TË DREJTOHEMI PËR TË KËRKUAR NDIHMË EKONOMIKE?

- Aplikimi bëhet nga kryefamiljari ose bashkëshortja pranë njesise administrative ku banon

CFARË PËRBAN APLIKIMI?

- Aplikimi përmban një sërë pyetjesh të cilat kanë për qëllim vlerësimin e gjëndjes reale ekonomike .Këto pyetje kanë të bëjnë me nr e anëtarëve të familjes , arsimimin, dhe punësimin e tyre , llojin e banesës , pasuritë dhe objekte të tjera në pronësi , si dhe të ardhurat

AVERIFIKOHEN DOKUMENTAT DHE INFORMACIONI QË JEPET GJATË PLOTËSIMIT TË APLIKIMIT ?

- Po, informacioni i dhënë gjatë plotësimit të aplikimit verifikohet në mënyre elektronike me institucionet e tjera shtetërore, si dhe fizikisht në vendbanim kur futen për herë të parë dhe dy herë ne vit

PO KUR KA MUNGESA NË DOKUMENTET OSE NË PLOTËSIMIN E APLIKIMIT PËR HERË TË PARË?

- Administratori shoqëror ju njofton për dokumentacionin e munguar dhe mban aplikimin dhe dokumentat shoqërues deri ne 30 ditë , në mënyrë që aplikuesi të ketë mundësi të plotësojë dokumentacionin

KUR PËRJASHTOHESH NGA NDIHMA EKONOMIKE ?

Nga ndihma ekonomike përjashtohesh nëse :

- Kryen ndarje të qëllimëshme të antarëve të familjes me përjashtim të rastit vajzë -- nënë
- Nuk tërheq në kohë ndihmen ekonomike
- Refuzon verifikimin e situates social-ekonomike në familje
- Fsheh informacionin / kryen deklarim te reme dhe nuk deklaron ndryshimet e situates social ekonomike
- Rofuzon përfshirjen në kurset e formimit professional ose ofertat e përshtatëshme për punë të zyrave t punës dhe nuk rezultojne punkërkues të papunë apo të vetë punësuar të zyrave të punës

SI LAJMËROHESH NËSE JË PËRZGJEDHUR?

- Ju mund të kërkoni informacion për pranimin ose refuzimin e saj prane njesise administrative ku banon në përfundim te muajit në të cilin aplikimi juaj është i vlefshem

KUSH KA TË DREJTË TË TËRHEQË PAGESËN E NDIHMËS EKONOMIKE ?

- Pagesa e ndihmës ekonomike tërhiqet dhe merret në dorëzim nga gruaja e familjes në nevojë dhe nga vete indiviti pranë postës ose në bankë

CFARË DUHET BËRË PËR TË VAZHDUAR MARRJEN E NDIHMËS EKONOMIKE PASI JE PËRZGJEDHUR?

- Të dy bashkeshortet dhe gjithë antarët mbi 18 vjec duhet të paraqiten cdo 3 muaj prane administratorit shoqëror për të plotësuar deklaratën mbi cdo ndryshim të situatës së tyre nëse ka ndryshuar

PO NËSE NDRYSHOHET VENDBANIMI?

- Ne rastet kur familja ndryshon vendbanim krahas ndryshimit të gjendjes civile transferohet edhe dosja e ndihmës ekonomike ne vendbanimin e ri .

A MUND TE KETË BONUSE NJË FAMILJË QË PËRFITON NDIHMË EKONOMIKE?

- Po, për cdo fëmijë qe ndjek arsimin e detyrueshëm dhe për cdo vaksinë të kryer ka në pagesë shtesë


A MUND TË ANKOHESH NËSE NUK JE PËRZGJEDHUR ?

- Po, fillimisht duhet bërë ankimi administrative pranë Bashkisë , ku aplikoni edhe per fondin e mbrojtjes sociale të Bashkive , dhe në rast se nuk gjeni zgjidhje ju keni të drejtë të ankimoni prane DRSHSSH . Pas anikimit administrative cdokush ka të drejtë ankimimi pranë Gjykatës Administrative

Pagesa llogaritet sipas strukturës së familjes duke llogaritur:

Kryefamiljarin dhe personin mbi moshë pune me 1800 (një mijë e tetëqind) lekë në muaj;
Anëtarin në moshë pune të familjes me 1260 (njëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekë;
Anëtarin nën moshë pune 900 (nëntëqind) lekë në muaj.

Nr	Viti	Nr i familjeve perfituese	Shuma
1	2015	1243	3812108
2	2016	1420	51948773
3	2017	1414	57017621
4	2018	1890	106723684



Burimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Strehimit


Përveç kësaj trajtohen:

- Fëmijet me status jetimi 3000 (tremijë) lekë;
- Viktimat e dhunës dhe trafikimit 3000 (tremijë) lekë;
- Fëmijët e lindur si trinjakë, katërnjakë apo pesënjakë 3000 (tremijë) lekë;
- Familjet kujdestare të fëmijëve jetimë 9000 (nëntëmijë) lekë;
- Kompensim për energjinë elektrike 1288 (njëmijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) lekë;
- Për fëmijët në arsimin e detyruar 300 (treqind) lekë për çdo fëmijë;
- Për vaksinimet e fëmijëve 100 (njëqind) lekë për çdo vaksinë.
- Sipas ndryshimit të fundit ligjor përfitimi i ndihmës ekonomike do të jetë i kufizuar në kohë deri në 5 vjet.

Ndihma ekonomike nga fondi i kushtëzuar.

Bazuar në ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" dhe " Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar, në Vendimin nr 955 datë 07.12.2016, udhëzimit nr 5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 përqind" si dhe udhëzimit nr 4 datë 17.02.2017 "Për llogaritjen e masës së përfitimit të ndihmës ekonomike " me vendim të vaçantë të Këshillit Bashkiak mund të përdoret deri në 6% të fondit të deleguar për të trajtuar familje të varfëra të cilat për shkak të kushtëzimeve të sistemit elektronik nuk përfitojnë nga ndihma e zakonshme, por që realisht janë shumë të varfëra.

Muaji	Fondi 6 %	
	Nr	Shuma
Janar	102	299520
Shkurt	104	304900
Mars	136	425100
Prill	133	382580
Maj	132	371780
Qershor	113	333080
Korrik	133	386720
Gusht	134	391760
shtator	133	383300
Tetor	108	302222
Nentor	110	308240
Dhjetor	119	354140



Aftësia e kufizuar.

Përfshin në programin e saj dhënien e pagesave kesh për personat e përcaktuar si të paaftë nga ana fizike dhe mendore që nuk lidhen me shkaqe punësimi, nga komisioni përkatës (KMCAP) që funksionon pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Baza ligjore VKM nr.618 datë 7.09.2006.

Për personat me kufizime të rënda përfitohet pagesa edhe për një kujdestare (Grupi i parë).

Nr	Viti	Nr i individeve	Shuma
1	2016	2264	227917188
2	2017	2255	226688686
3	2018	2020	233092489

Pagesat për shkak të verbërisë.

Baza ligjore VKM nr.277 datë 18.06.1997 "Përfitimet nga statusi i të verbërit".

Vlerësimi i nivelit të aftësisë së tyre bëhet nga KMPV që funksionon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Pagesat për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Janë persona që trajtohen mbi bazën e VKM nr.31 datë 20.01.2001 "Për përfitimet nga statusi i invalidit para e tetraplegjikë".

Vlerësimi i tyre bëhet nga KMCAP vendore dhe konfirmohen nga Shërbimi Social Shtetëror (persona që nuk levizin për shkak të mosfunksionimit të dy anësive ose të kater anësive).

Këta persona përfitojnë edhe pagesë për pajisje higjeno-sanitare në masën 16.000 lekë në muaj për person.

Pagesat për Invalidët e punës.

Baza ligjore VKM nr.869 datë 18.06.2008 "Për përfitimet në formë të ndihmës ekonomike nga statusi i invalidit të Punës"

Janë përfitues ata persona që janë përcaktuar si të tillë nga KMCAP-i rrethit për shkaqe që lidhen me punësimin (Pra për shkak të kontributeve të sigurimeve shoqërore); por që përveç trajtimit nga ky institucion marrin edhe një pagese shtesë në formën e ndihmës ekonomike pranë njësite vendore.

Pergj. Sek.

Ermanda Petriti

